

VENDIM
Nr. 245, datë 30.9.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “VIVID POWER” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2467/2 prot., datë 23.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Vivid Power’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Vivid Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2467 prot., datë 17.9.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për pikën 1.1, gerrat “a” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; si dhe pikën 2.5.

- Shoqëria duhet të plotësojë më tej informacionin/dokumentacionin si vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

Pika 1.1, “Formati i aplikimit”, sipas përcaktimeve të shtojcës 1.

- **Germa “b”:** Rezulton se shoqëria ka plotësuar NIPT-in dhe emrin e subjektit për një shoqëri të ndryshme nga shoqëria aplikuese, ndaj duhet të ridepozitojë shtojcën 1 me saktësimet përkatëse.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- **Germa “a”:** Shoqëria duhet të shlyejë detyrimet ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të depozitojë në ERE një vërtetim të përditësuar.

- **Germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë një vendim të organeve drejtuese për të dedikuar vlerat respektive, në kuadër të financimit të secilës prej veprimtarive (duke qenë se ka aplikuar paralelisht dhe për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike), si dhe të depozitojë dokumentacion vërtetues për disponimin e pjesë së mbetur të mbështetjes financiare.

- **Germa “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë planin e biznesit për 5 vjet, ku të përfshihet dhe mënyra e financimit të veprimtarisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti